



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 979/ prot.

Tiranë më 15.7.2019

Lënda: Kthim përgjigje mbi Rregulloren për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.1467/2 Prot, datë 19.06.2019, për këshillimin publik mbi Rregulloren për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, vlerësojmë si të rëndësishëm marrjen në konsideratë të disa propozimeve lidhur kryesisht me Aneksin 1 të dokumentit të nxjerrë për këshillim publik, sa i përket krijimit të bazës së të dhënave nga të gjithë operatorët e shërbimeve publike telefonike për regjistrin "Do Not Call Me" për thirrjet telefonike të e pa kërkuara nga kompanitë marketing.

Duke vlerësuar këtë nismë, ju informojmë se Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në vitin 2015, nisur edhe nga iniciativa e Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për disa ndryshime në ligjin nr.10128/2008 "Për tregtinë elektronike", hartoi projektligjin "Për Krijimin e Regjistrit të Komunikimeve/Thirrjeve Tregtare të pa Kërkuara", projekt i cili nuk është miratuar ende. Qëllimi i këtij projektligji është pikërisht krijimi i regjistrit të komunikimeve tregtare të pa kërkuara, si dhe përcaktimi i rregullave për përdorimin, aksesimin, administrimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Nevoja e hartimit të këtij projektligji, erdhi si rezultat i ankesave të shpeshta pranë Zyrës së Komisionerit lidhur me shqetësimin e marrjes së telefonatave të pa kërkuara nga ofrues të ndryshëm shërbimi, të cilët përmes komunikimit synojnë të ushtrojnë aktivitetet promovionale.

Ndryshe nga sa parashikohet në Aneksin 1 të Rregullores, sipas së cilës çdo sipërmarrës ofrues i shërbimit publik telefonik ka detyrimin që të krijojë një bazë të dhënash të pajtimtarëve për të mos marrë thirrje/komunikime të pa kërkuara, projektligji parashikon

krijimin e një Regjistri të vetëm për këtë qëllim. Një propozimi i tillë vjen edhe sepse eksperiencia ndërkombëtare ka treguar që është më efektiv krijimi i një regjistri të vetëm, për të menaxhuar në mënyrë më të përqendruar regjistrin e përjashtimeve nga thirrjet e padëshiruara ose pa marrë pëlqimin paraprak të subjekteve të të dhënave. Kjo është një praktikë e aplikuar në mënyrë efektive në disa vende të (BE-së), si Britani e Madhe, Francë, Itali etj.

Projektligji i propozuar është në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi të dhënat e regjistruara në këtë regjister përbëjnë dhe evidentojnë të dhëna personale të individëve të cilët marrin komunikime tregtare të pa kërkuara, dhe për këtë shkak të dhënat e tyre duhen mbledhur, regjistruar, përpunuar, ruajtur në përputhje me këtë legjislacion. Kjo është edhe arsyeja që Zyra e Komisionerit mund të jetë një administrator i mirë i kësaj baze të dhënash, si autoriteti mbikëqyrës dhe kontrollues i përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, ashtu sikundër mund të jetë edhe një administrator tjetër përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e këtij regjistri.

Në hierarki edhe të normave ligjore, vlerësojmë se rregullimi me ligj i kësaj çështje do të siguronte një nivel më të lartë zbatueshmërie. Gjithashtu ndjekja e procedurave për miratimin e këtij projektligji është pjesë e planit të punës së Zyrës së Komisionerit për vitin 2019, duke u nisur edhe nga fakti i numrit të shtuar të ankesave që vijnë në lidhje me marrjen e telefonatave të pa kërkuara.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit mbetet e hapur për të diskutuar në lidhje me këtë propozim dhe çështjet objekt diskutimi me qëllim finalizimin e kësaj praktike.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

